VENDIM
Nr. 352, datë 11.5.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT INFORMATIK FINANCIAR TË QEVERISË (SIFQ)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të thesarit, të quajtur Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ).
2. SIFQ-ja përmban:
a) të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit të njësive të qeverisjes së përgjithshme;
b) të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare të qeverisë, në përputhje me bazën ligjore për financat publike;
c) të dhëna referenciale për ndërveprimin dhe baza të dhënash të tjera;
ç) informacione të tjera plotësuese, për procese të punës së financave të shtetit;
d) të dhëna për raporte financiare dhe statistika.
3. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.
4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:
a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e gjeneruara nga SIFQ-ja dhe që kanë të bëjnë me kodifikimin e klasifikimit buxhetor e kontabël, të cilat janë:
i) Kodet e institucioneve;
ii) Kodet e ministrive të linjës;
iii) Kodi i kapitullit (burimi i financimit);
iv) Kodi i programit;
v) Kodet e llogarive ekonomike;
vi) Kodet e entiteteve qeverisëse;
vii) Kodet e nënllogarive;
viii) Kodet e degëve të thesarit;
ix) Kodi i projektit.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat referenciale:
i) të bankave të nivelit të dytë, si IBAN-i, numri i llogarisë bankare, adresa e bankës;
ii) të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si NIPT-i i subjektit/institucionit.
5. Subjektet përgjegjëse të SIFQ-së, janë, si më poshtë vijon:
a) Institucioni administrues i SIFQ-së është Ministria e Financave;
b) Institucionet, palë të interesuara, janë: Ministria e Financave, degët e thesarit, institucionet që operojnë me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, PIU-projektet me financim të huaj, bankat e nivelit të dytë dhe universitetet publike që kanë akses me ndërfaqe me SIFQ-në.
6. Dhënës të informacionit janë:
a) degët e thesarit;
b) Ministria e Financave;
c) institucionet që operojnë me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ;
ç) Banka e Shqipërisë;

d) bankat e nivelit të dytë;
dh) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
e) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
ë) Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
f) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Sigurimit Shëndetësor;
g) projektet me financim të huaj.
7. Subjekte të interesuara, janë:
a) Ministria e Financave;
b) degët e thesarit;
c) institucionet që kanë akses të drejtpërdrejtë në SIFQ;
ç) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
d) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
dh) Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
e) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Sigurimit Shëndetësor;
ë) projektet me financim të huaj;
f) Banka e Shqipërisë;
g) universitetet publike, që kanë akses në ndërfaqen me SIFQ-në;
gj) bankat e nivelit të dytë;

h) çdo subjekt tjetër, i përcaktuar shpre-himisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të SIFQ-së është, si më poshtë vijon:

a) Administratorët e SIFQ-së kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave në SIFQ, në lidhje me menaxhimin e përdoruesve, klasifikimin buxhetor e kontabël dhe subjekteve të regjistruara;

b) Degët e thesarit kanë të drejtë leximi, shkrimi/modifikimi ose anulimi vetëm për transaksionet që regjistrojnë në SIFQ, dhe të drejtë leximi/monitorimi të balancave buxhe-tore/kontabile të institucioneve të varësisë;

c) Ministritë e linjës kanë të drejtë leximi, shkrimi/modifikimi ose anulimi vetëm për transaksionet që regjistrojnë në SIFQ;

ç) Banka e Shqipërisë ka të drejtë leximi, për pagesat që regjistrohen në SIFQ dhe shkrimi, për konfirmimin e shlyerjes së pagesave, nëpërmjet dërgimit të skedarëve të konfirmimit, të cilët importohen në SIFQ;

d) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka të drejtë leximi për pagesat në favor të DPT-së, që regjistrohen në SIFQ dhe të drejta shkrimi për konfirmimin e shlyerjes së pagesave, nëpërmjet dërgimit të skedarëve të konfirmimit, të cilët importohen në SIFQ dhe kontabilizimit të të ardhurave tatimore;

dh) Bankat e nivelit të dytë kanë të drejtë shkrimi për rakordimin e pagesave që regjistrohen në SIFQ dhe shlyhen nga bankat, nëpërmjet dërgimit të skedarëve të konfirmimit, të cilët importohen në SIFQ;

e) Universitetet publike kanë të drejtë leximi për transaksionet e pagesave që regjistrohen në SIFQ në favor të tyre, nëpërmjet aksesimit të raporteve të të ardhurave;

ë) ISSH-ja dhe FSDKSH-ja kanë të drejtë leximi dhe shkrimi/modifikimi të balancave kontabile të institucioneve të tyre respektive;

f) Ministria e Financave ka të drejta admini-strative mbi SIFQ-në, në rolet:
i) Administrator;
ii) Raportues;
iii) Auditues;
iv) Zhvillues.

9. Baza e të dhënave e SIFQ-së ndërvepron me baza të tjera të dhënash: me sistemin e tatimeve, me Bankën e Shqipërisë, me bankat e nivelit të dytë dhe me universitetet.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama